



REVISTË SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" PRISHTINË



Nr. 50 / Shkurt 2025

DRITA e نور القرآن KURANIT



BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVES
DREJTORIA E ARSIMIT
SHML "MEDRESEJA ALAUDDIN" Prishtinë
Paralelja në Gjilan



23.12.2024

Amfiteatri i Paraleles në Gjilan.

ÇASTE NGA MANIFESTIMI I FESTËS SË FLAMURIT



Përmbajtja:

FUQIA E ËNDRRAVE DHE KËMBËNGULJES	4
KREMTIMI ME RASTIN E MUAJIT TË MEVLUDIT NË MEDRESE MUHAMEDI A.S, KRENARIA JONË	5
PARLAMENTI I NXËNËSVE MBAN ZGJEDHJET	6
PROGRAM MIRËSEARDHJEJE	7
EKSKURSIONI I MATURANTËVE TË MEDRESESE	8
EKSKURSIONI I MATURANTEVE TË MEDRESESE	9
KLUBI I BASKETBOLLIT "KARROCAT E KALTRA"	10
MUAJI "ROZË", LIGJËRATË E HAPUR	10
MEDRESEJA, PJESËMARRËSE NË GARAT E MATEMATIKËS	11
SHËNIMI I FESTËS SË 28 NËNTORIT NË SHKOLLËN TONË!	12
MEDRESEJA FESTON DITËN NDËRKOMBËTARE TË GJUHËS ARABE	13
DJE, SOT DHE NESËR	14
POETËT	15
TURNIRI I FUTBOLLIT SHKOLLOR	16
TURNIRI I FUTBOLLIT NDËRSHKOLLOR	17
MEDRESEJA, E AFTË EDHE NË MUNDJE!	17
AKTIVITETI NDËRKURRIKULAR (KURAN-DAVE-SOCIOLOGJI)	18
KONFERENCA "GITOMUN" NË STAMBOLL	19
THE GREAT LAUNDRY INCIDENT	20
LARG NGA VENDI IM	20
BIRI IM	21
SINQERITET	21
HAYAT SUDAN GELIR	23
VAZGEÇME	23
PJESËMARRJA NË KUVENDIN E ORGANIZUAR NGA KYC	24
KONFERENCA "NXËNËSIT, PAQJA DHE SIGURIA"	24
"16 DITË TË AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS NË BAZA GJINORE"	25
PINGPONG	25
GARAT E VOLEJBOLLIT	26
"MREKULLIA E KRIJIMIT	27
30 VJETORI I MEDRESESE ALAUDDIN – PARALELJA GJILAN	28
GRUPI I NXËNËSVE TË DALLUAR TË MEDRESESE VIZITOJNË STAMBOLLIN	29
NXËNËSET E DALLUARA VIZITOJNË ANTALINË	30
DELEGACIONI I MEDRESESE VIZOITON ANKARANË	31
FJALËTËRTHORE	32

FJALA E REDAKSISË

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit Mëshirëbërësit!

Falënderimet dhe lavdërimet më kulmore i takojnë Allahut xh.sh., i Cili na bekoj me mirësi të panumërta, e njëra ndër to është edhe mundësia për të qenë sebeb në punë të hairit.

Salatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin s.a.v.s., mbi familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e Tij deri në Ditën e Gjykimit.

Revista "Drita e Kuranit" është shprehje e vullnetit, punës dhe përkushtimit të nxënësve të shkollës sonë. Gjë e cila u dëshmuar edhe këtë herë me numrin më të ri të kësaj reviste.

Për realizimin e saj falënderojmë së pari Krijuesin Fuqiplotë e së dyti nxënësit dhe nxënëset e shkollës sonë, pastaj drejtorinë e shkollës, stafin edukativo-arsimor, kryesinë e nxënësve, anëtarët e palodhshëm të redaksisë dhe gjithë ata që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte kontribuuan në të.

U përpoqëm që në përmbajtjen e këtij numri të përmbledhim aktivitete e vepra interesante, të cilat veç që janë dobiprurëse, janë edhe argëtuese, krejt me shpresë se do t'ju lënë mbresa atyre që i shfletojnë faqet e saj.

Për fund, lusim Allahun e Lartësuar që të vazhdojë edhe më tutje tradita e revistës "Drita e Kuranit", e njëherësh edhe aktivitetet dhe angazhimi i nxënësve të kësaj shkolle të bekuar!

Ron Bajoku, 12/2

Kryeredaktor: Emir Koprani 12/2

Redaktore: Dua Çmega 12/4

Anëtarë:

Vullnet Musliu 12/1, Haris Avdyli 12/2, Ibrahim Mehmeti 12/3, Merjeme Shabani 12/4, Lejla Morina 12/5, Sead Veseli 11/1, Ron Bajoku 11/2, Esmat Sylejmani 11/3, Lumniye Sadiku 11/4, Azem karaxha 10/1, Naser Mehmeti 10/2, Anika Saiti 10/3 dhe Emira Mehani 10/4.

Lektor dhe redaktor letrar: **Besnik Jaha**

Redaktura kompjuterike: **Bashkim Mehani**

Dizajni: **Emir Mehani**

E-mail: **redaksia15@hotmail.com**

www.medreseja.com

FUQIA E ËNDRRAVE DHE KËMBËNGULJES

Çdo njeri ka brenda vetes një thesar të fshehur, një ëndërr, një qëllim, apo një dëshirë që ndriçon rrugën e tij në jetë. Ëndrrat janë si yjet, ndonëse ndonjëherë duken të largëta dhe të paarritshme, ato na e japin një drejtim, një arsye për të ecur përpara. Por çelësi për t'i shndërruar ëndrrat në realitet është këmbëngulja – ajo forcë e brendshme që na bën të vazhdojmë, edhe kur rruga duket e vështirë.

Jeta është plot me sfida dhe pengesa. Shpeshherë, këto sfida mund të na bëjnë të dyshojmë në vetvete, të mendojmë se ndoshta ëndrrat tona janë tepër të mëdha për t'u realizuar. Por pikërisht në ato momente, është e rëndësishme të kujtojmë se çdo arritje e madhe në histori ka filluar me një hap të vogël dhe një zemër plot guxim. Thomas Edison, pasi kishte dështuar mijëra herë për të shpikur llambën elektrike, tha:

“Unë nuk kam dështuar. Kam gjetur mijëra mënyra që nuk funksionojnë.” Kjo është fuqia e këmbënguljes, të shohësh dështimet jo si fundi i rrugës, por si mësim që të çojnë më pranë suksesit.

Frymëzimi nuk vjen gjithmonë nga jashtë, ai buron nga brenda. Për të arritur qëllimet tona, duhet të besojmë në fuqinë tonë të brendshme, të ndjekim pasionin tonë me një bindje të palëkundur. Çdo herë që ndjejmë lodhje apo demoralizim, duhet të ndalemi për një çast dhe të kujtojmë arsyen pse kemi nisur këtë rrugë. Kur fokusohemi tek arsyeja jonë më e thellë, sfidat fillojnë të duken më të vogla, dhe ne e gjejmë fuqinë për të vazhduar përpara.

Ëndrrat nuk janë thjesht përfitime personale, ato janë burim frymëzimi për të gjithë ata që na rrethojnë. Kur një njeri ndjek pasionin e tij, ai ndriçon rrugën për të tjerët, duke treguar se gjithçka është e mundur, kur besojmë dhe punojmë fort. Një ëndërr e ndjekur me zemër mund të bëhet një dhuratë për botën, duke ndryshuar jetë dhe duke lënë një gjurmë të pashlyeshme.

Prandaj, mos ki frikë të ëndërrosh. Mos lejo që zërat e dyshimeve të shuajnë zjarrin e pasionit tënd. Ji këmbëngulës, ji i guximshëm, dhe mbi të gjitha, beso në vetvete. Rruga mund të mos jetë gjithmonë e lehtë, por çfarëdo që të ndodhë, mos harro se yjet ndriçojnë më fort në errësirën më të thellë. Dhe një ditë, kur të arrish majat që ke ëndërruar, do të kuptosh se çdo hap, çdo sakrificë dhe çdo dështim ia kanë vlejtur. Suksesi nuk është vetëm arritja e qëllimit, por edhe ndryshimi që ndodh tek ne gjatë rrugës.

Emira Mehani 11/4

KREMTIMI ME RASTIN E MUAJIT TË MEVLUDIT NË MEDRESE

MUHAMEDI A.S, KRENARIA JONË

Në Medresenë “Alauddin”, më datë 23.09.2024 u kremtua lindja e të Dërguarit a.s. Me këtë rast u organizua një manifestim i mrekullueshëm, kushtuar jetës dhe veprës së Resulullahut s.a.v.s, nga veprimtaria e të cilit ne gjithëherë vjelim mësim me vlera të shumta.

I gjithë programi u realizua nën përkujdesjen dhe moderimin e nxënësve Visar Rama dhe Esra Bytyqi.

Në hyrje të programit u kënduan disa ajete nga Kurani Famëmadh të interpretuara nga nx. Uvejs Pajaziti, klasa 12/2;

Drejtori i shkollës, prof. Fadil ef. Hasani pati një fjalë rasti, ku foli rreth rëndësisë së kremtimeve që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në kuadër të Mevludit;

Fjala më pas i takoi Kryeimamit të BIK-ut Vedat ef. Sahitit, i cili foli rreth traditës së festimit të kësaj ngjarjeje të madhe në vendin tonë;

Një përshkrim rrëqethës e me stil të lartë na e dha profesori Driton ef. Arifi rreth shëmbëlltyrës së Muhamedit a.s;

Freski e hijeshi i dhanë programit kori i vajzave dhe ai i djemve me kaside dedikuar Pejgamberit a.s;

Interes të madh e entuziazëm solli interpretimi i mahnitshëm i mulla Adem Hoxhës nga Ferizaj, i cili këndoi një pjesë nga mevludi tradicional i vendit tonë;

Pastaj vëllezërit Allajbegu na freskuan me ilahi të bukura;

Për fund, drejtori i shkollës shpërndau mirënjohje për kujdestarin më të mirë të vitit 2023/24, e që i takoi prof. Ekrem ef. Maqedonci dhe klasën më të dalluar, klasën 10/3, me kujdestare, prof. Saranda Kamberi.

Kështu përfundoi ky program i bereqetshëm e i pasur me vlera dhe aktivitete!



PARLAMENTI I NXËNËSVE MBAN ZGJEDHJET

Nën moton “Lider nuk është ai që është në krye, por ai që kujdeset për ata që janë nën drejtimin e tij” u mbajtën zgjedhjet për kryetar të parlamentit në shkollën tonë. Patë 54 anëtarë të pranishëm, përfaqësues të klasave.

Kryetari i komisionit zgjedhor ishte prof. Muharrem ef.

Tërnava i shoqëruar edhe nga anëtarët e komisionit, prof. Shkëlzen Hoxha, prof. Valbona Asllani dhe prof. Ajet Ajeti.

Kandidatët e nominuar ishin:

Belkisa Myrta – 12/3

Enes Islami – 12/2

Rujejda Bejtullahu – 12/4, dhe

Shpëtim Smajli- 12/1

Kandidatët në fjalë shpalosën planprogramin e tyre për shkollën. Nga rezultati i votimeve, nxënësjë Ruvejda Bejtullahu u zgjodh kryetare e PN-së, ndërsa nxënësi Enes Islami nënkryetar i saj.

Urojmë që nga tani, ky rezultat të reflektoj në punë, zhvillim e përparim për të gjithë ne!



PROGRAM MIRËSEARDHJEJE

Për të treguar ngrohtësinë e miqësinë e pashembullt që frymon në Medresenë Alaudin, maurantet në bashkëpunim me vajzat e kl.11-ta, organizuan një program simbolik enkas për nxënëset e reja të klasës së 10-të, ose siç njihen te ne “fazankat”.

Bereqeti i kësaj shkolle të bekuar u dëshmuar edhe me numrin e nxënësve të pranuar për këtë vit shkollor e që ka thyer rekord.

Si çdo herë programi filloi me recitimin e disa ajeteve të Kuranit fisnik nga nx. Sumeja Ahmeti 12/4;

Programi vazhdoi nën moderimin e nxënësve Rona Jaha, 12/3 dhe Ruvejda Kaçiu, 12/4;

Një fjalë rasti e pati drejtori i Medresesë, prof. Fadil ef. Hasani dhe kujdestarët e klasave të 10-ta tashmë, prof. Samir Ahmeti 10/5 dhe prof. Driton Arifi 10/3;

Kori i vajzave interpretoi ilahinë “Në Meken e largët në Arabi”;

Esma Sylejmani 12/3 pati një interpretim mahnitës i cili sillej rreth vlerës së Medresesë duke iu referuar si vatër e dijes;

Xheneta Gërvalla 11/3 pasoi me një interpretim po ashtu mbresëlënës të monolgut të përgatitur nga vetë ajo, “Kandil ndriçues”;

Pati një pjesë teatrale e cila e mbërtheu audiencën, të shfaqur nga nxënëset Anisa Asllani, Erda Musliu, Emire Hashani dhe Melika Muhaxhiri nga klasa 12/4;

Disa vargje u interpretuan nga nxënëset Diellza Berisha dhe Emire Hashani të klasës 12/4;

E për fund, pati disa sllajde argëtuese e nga një dhuratë për secilën nga fazankat.



EKSKURSIONI I MATURANTËVE TË MEDRESESË

Nga data 14 tetor e deri më 18 tetor 2024, maturantët e shkollës sonë kaluan pesë ditë të mrekullueshme në ekskursionin që u organizua në Shqipëri.

Morën pjesë 72 maturantë dhe 92 maturanter, nën përkujdesjen e kujdestarëve/eve të tyre.

Në vijim, një përshkrim i shkurtër i agjendës, dita e parë: Vizitë qytetit të Gjirokastrës, me ç'rast u vizitua edhe kalaja e këtij qyteti historik e artistik. Në çdo cep i vërehej një arkitekturë e veçantë e shtëpive dhe rrugëve. Ndërsa peizazhi në sfond krijonte një ndjenjë mahnitëse, xhamia e vjetër prej guri pak e ngritur na dhuroi një freski të veçantë ku edhe falëm namazin. Më pas arritëm në Ksamil ku u akomodua.

Dita e dytë: Vizitë tek Syri i Kaltër, ku të falej ndjesia se gjithçka po ngatërrohej mes reales e imagjinares, me ujin e të cilit u freskuam. Pastaj vizituam Butrintin me monumentet e tija. Ndërsa ecnim në rrugët e këtij qyteti, ndjenim një frymë që pushonte ndër shekuj. Një përjetim interesant.

U kthyem në hotel të lumtur me ç'kishim parë, për ta vijuar sërish vizitën tek të tre ishujt, pas një pushimi të shkurtër. Në plazh kaluam momente relaksimi e argëtimi.

Mbrëmja e kësaj dite na gjeti në qytetin e Sarandës i cili dukej i mahnitshëm, për të përjetuar momente të tjera të veçanta.

Dita e tretë: Kthimi përmes Gjirokastrës, vizita e Kalasë së Beratit, këtij qyteti, arkitektura e të cilit na

e kujtonte Prizrenin tonë të dashur, por më madhështor e më i bukur. Në mbrëmje arritëm në hotel në Durrës, ku patëm kohën e shëtitjes dhe më pas, fjetja.

Dita e katërt: Vizita e Tiranës/xhamisë së re të "Namazgjasë", na gëzoi e na dha momente freskie imanore, atë ndjenjë misterioze sigurie e vëllazërie, që vetëm shtëpitë e Allahut, dinë të ta dhurojnë. Ky entuziazëm u pasua me një tjetër kur vizituam Kalanë e Durrësit, ndërsa shëtitëm si pjesë e kohës së lirë.

Dita e pestë: Vizitë qytetit të Shkodrës dhe hapësirave kulturore të këtij qyteti historik, qytetarët e të cilit reflektojnë kulturë e arsim.

Në hapësirat e tij reflektonte jo veç qytetaria, por po aq edhe fryma fetare e imanore. Veçanërisht kjo u vu në dukje kur vizituam ambientet e një vatre tjetër të dashur ku mësohet feja e Allahut. Fjala është për Medresenë "Haxhi Sheh Shamia". Pas saj, kthimi në Kosovë na gjeti të gëzuar, duke bartur kujtime të mrekullueshme.

Falënderim i veçantë i takon kujdestarëve, prof. Besnik Jaha për klasën 12/1 dhe prof. Muharrem Tërnavë për klasën 12/2 e edukatorit Dr. Muhamed Stublla për përkujdesjen dhe mundin e tyre që çdo gjë të jetë në rregull vazhdimisht, si dhe drejtorinë e shkollës për mundësinë e ofruar.

Një eksperiencë e paharruar!



EKSKURSIONI I MATURANTEVE TË MEDRESESË



Agjenda e ekskursionit të nxënëseve ishte si në vijim, dita e parë: Vizitë qytetit të Shkodrës dhe medresesë së këtij qyteti, që qe një sihariq se do të përjetojnë një eksperiencë të paharruar. Kjo vizitë u përcoll me vizitën e Shirokës e më pas edhe Golemit, e në fund u bë akomodimi.

Dita e dytë: Vizitë Tiranës/xhamisë së “Namazgjasë” për të përjetuar çaste të bukura. Më pas, në kohë e lirë, në bregdetin e Golemit dhe krejt në mbrëmje vizitë Durrësit, për t’u argëtuar në shëtitje deri vonë.

Dita e tretë: Vizitë qytetit të Beratit, qytetit që ngrihej mbi një kulturë të pasur e një frymë vëllazërie të pakundshoqe. Jo më pak se kjo la mbresa qyteti artistik i Gjirokastrës, ky qytet i vjetër e piktoresk. Më pas, arritja në Ksamil për të darkuar rreth orës 20:00.

Dita e katërt: Vizitë Syrit të Kaltër, kësaj mrekullie të vërtetë natyrore e dëshmie të krijimtarisë së mahnitshme të Allahut Fuqiplotë. Vizitë iu bë më pas qytetit antik të Butrintit. Kultura e të cilit të mahniste me një historinë e lashtë, të gdhendur, murosur, arnuar, e vjetruar gjer në dëshmi të pashlyeshme. Më pas u kthyen në Ksamil e nga

mbrëmja vizituan edhe qytetin e Sarandës ku kaluam çaste për të mos i harruar.

Dita e pestë: Vizitë qytetit të Lezhës, qytetit të Shkodrës, gjegjësisht Liqenit të Shkodrës, Kalasë së Rozafës dhe Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”. Copëzat e pashlyeshme të kujtimeve të bukura nga kjo vizitë, ngelën përgjithmonë në zemrat e maturantëve.

Së fundmi, edhe kthimi në Kosovë ishte i mirëpritur.

Një falënderim i veçantë shkon për kujdestarët e maturanteve prof. Shkëlzen Hoxha për klasën 12/3 dhe prof. Valbona Asllani për klasën 12/4; si dhe bacën Izet, të cilët u përkujdesën gjatë gjithë kohës që çdo gjë të shkonte siç duhej.

Falënderojmë gjithashtu edhe drejtorinë e shkollës në krye me prof. Fadil ef. Hasanin për mundësinë e dhënë!

Vërtetë qe një përjetim për tu mbajtur mend!

KLUBI I BASKETBOLLIT “KARROCAT E KALTRA”

Në Medresenë “Alauddin” nuk mungon përkrahja ndaj aktiviteteve të dobishme e me karakter sensibilizues!

Më datë 24.09.2024, u zhvillua një ndeshje argëtuese basketbolli ndërmjet klubit “Karrocet e kaltra” dhe nxënësve të shkollës sonë.

Ky aktivitet u mundësua nga SHH “Bereqeti”, OJQ-ja “Replay Peace” të Drejtorisë për sport të Komunës së Prishtinës dhe Medreseja “Alauddin”. Ngjarje e cila tërhoqi edhe mysafirë nga KFORI amerikan, ai italian dhe drejtorja e OSBE-së.

Në fund u shpërndanë medalje dhe certifikata, ndërsa u thanë disa fjalë nga organizatorët e kësaj mbledhjeje të paharrueshme.



MUAJI “ROZË”, LIGJËRATË E HAPUR

Meqë muaji tetor njihet ndryshe edhe si “Muaji Rozë”, ose muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, në Medrese nuk mungoi një ligjëratë dobiprurëse mu për këtë temë, e zhvilluar më datë 26.10.2024.

Tema: Ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit

Vendi: Amfiteatri i shkollës

Ligjëruese: Dr. Fatmire Ademi Halili

Pjesëmarrëse: Nxënëset e shkollës amë në Prishtinë Doktoresha shpalosi masat parandaluese për këtë sëmundje dhe se si duhet trajtuar. Motoja që u vu në theks nga kjo ligjëratë ishte “Parandalimi është më i rëndësishëm se shërimi”.

Natyrisht se ligjëratat e tilla të cilat si thelb e kanë ndërgjegjësimin janë të mirëpritura në shkollën tonë.



MEDRESEJA, PJESËMARRËSE NË GARAT E MATEMATIKËS

Medreseja amë në Prishtinë bashkë me paralelet e saj në Prizren e Gjilan, morri pjesë me nxënësit e saj të zellshëm e të zgjuar në Olimpiadën e XV-të të Matematikës në nivel komunal.

Sukses pak më të lartë në këtë garë nga Medreseja, arriti nx. Musab Bunjaku 12/8 nga paralelja e ndarë fizike në Gjilan, i cili nën përgatitjen e prof. të matematikës Bergan Isufi, zuri vendin e dytë, duke e bërë shkollën krenare.

Jo shumë larg nuk janë nx. nga Medreseja e Prishtinës, Muhamed Osmani 11/1 në nivel të

klasave të XI-ta e nx. Visar Rama 12/1 në nivel të klasave të XII-ta.

Çfarë ia shton vlerën edhe më këtyre sukseseve është fakti se orët e matematikës që mbahen në Medrese janë me fond shumë më të ulët se sa shumë shkolla të tjera e ndaj të cilave Medreseja ka shfaqur epërsi.

Ne urojmë nxënësit tanë fitues, dhe gjithë të tjerët që ishin pjesëmarrës. Ne krenohemi me ju!



SHËNIMI I FESTËS SË 28 NËNTORIT NË SHKOLLËN TONË!

Më datë 27 Nëntor, në amfiteatrin e shkollës sonë u shfaq një program festiv me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit.

Audiençën e programit e përbënë Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë, drejtori prof. Fadil ef. Hasani, profesorët, profesoreshat dhe nxënësit.

Në hyrje, si çdo herë për t'i dhënë mbarësi programit, u recituan disa ajete nga Kurani Famëlartë nga nxënësi Sejjid Idrizi;

Programi vazhdoi nën moderimin e nxënësve: Omer Demolli e Lumnie Sadiku, të cilët i dhanë më pas një fjalë rasti Myftiut të BIK-ut Mr. Naim ef. Tërnavë, drejtorit të Medresesë prof. Fadil ef. Hasani dhe kryetares së PN-së Ruvejda Bejtullahu;

Pasoi kori i djemve me këngën “Mora fjalë”;

Një interpretim të bukur të disa vargjeve të përmbledhura na e dhanë koreografia e përbërë nga nxënësit: Sumeja Bajrami, Fetije Krasniqi, Lumnie Sadiku, Erion Fetahu, Ron Bajoku, Harisa Muharremi dhe Xheneta Gërvalla;

Në skenë më pas doli aktori i njohur Ismet Azemi, i cili interpretoi një këngë për Zahir Pajazitin, ilahinë

“Perëndi, vetëm ty të bie në gjunjë” dhe një këngë të tjera patriotike;

Kori i vajzave këndoi këngën “Ti Shqipëri më jep nder”;

Për fund, programi u përmbyll me shpërndarjen e certifikatave për fituesit e garave që janë mbajtur paraprakisht në ese dhe në poezi.

Programe të tilla na argëtojnë e na kënaqin pa masë!



MEDRESEJA FESTON DITËN NDËRKOMBËTARE TË GJUHËS ARABE

Një program i mahnitshëm e jo i zakonshëm për 18 dhjetorin, Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës arabe u shfaq në amfiteatrin e shkollës sonë.

Salla ishte e mbushur me të ftuar, të cilët dëshmuuan për këtë shfaqje të mahnitshme të përgatitur nga nxënësit tanë.

Për gjithë këtë duhet falënderuar në mënyrë të posaçme monitoruesi, hartuesi e mbikëqyrësi i këtij programi, prof. Shkëlzen Hoxha. Me punën dhe angazhimin e tij, së bashku me drejtorinë, stafin edukativo-arsimor si dhe nxënësin Visar Rama 12/1, janë më meritorët për të gjitha përgatitjet e domosdoshme e të nevojshme teknike.

Siç e ka edhe zakoni i programeve tona, u fillua me recitimin e mahnitshëm të disa ajeteve nga Kurani Fisnik, nga nx. Ensar Januzaj, kl.12/1;

Programi vazhdoi nën moderimin e nxënësve Enes Bytyqi, 12/2 dhe Ruvejda Bejtullahu, 12/4;

Nga një fjalë përshëndetëse iu dha Sekretarit të BIK-ut Ahmet ef. Sadriu dhe drejtorit të Medresesë prof. Fadil ef. Hasani;

Më pas, fjala i takoi kryetarit nga djemtë Enes Islami, 12/2, i cili foli me një gjuhë të rrjedhshme e të këndshme arabe duke përshëndetur të pranishmit dhe duke u uruar Ditën e Gjuhës Arabe.

Programi vazhdoi me interpretimin e ilahisë “Ja Nabi

Selam Alejke” nga kori i djemve, e që ishte një interpretim mbresëlënës;

Pastaj u interpretuan në mënyrë brilante disa vargje poezie nga Divani i imam Shafiut, nga nx. Ron Bajoku, 12/2;

Poezia ia la vendin esesë në gjuhën arabe me titull “Mirësia e Zotit tonë”, e interpretuar nga nx. Erda Musliu, 12/4;

U interpretua edhe ilahia “Esselemu Alejke” nga kori i vajzave për t’i freskuar zemrat e të pranishmëve;

Të dhëna interesante rreth historikut të shkollës sonë na i dha nx. Belkisa Myrta, 12/3, që nga aktivitetet e ndryshme të zhvilluara në shkollë, e gjerë te nxjerrja e kuadrove të dëshmuara nga nxënësit;

Fjalimi mbresëlënës që dha nxënësi Enes Hoti, 12/1 rreth vlerës së gjuhës arabe, për çka zgjoi interesim të madh në mesin e të pranishmëve;

Krejt në përmbyllje të këtij programi, në monitor, u shfaqën disa video të nxënësve tanë të cilët shprehnin aftësitë e tyre, duke qenë njëkohësisht ambasadorë të denjë të shkollës në aktivitete të ndryshme.

Padyshim se ky program zë një vend të veçantë në historinë e artë të kësaj shkolle.



DJE, SOT DHE NESËR

Është më se e vërtetë, gjërat nga e kaluara, hapat, veprimet dhe përgjithësisht përjetimet tona, kthehen në gjurmë për të ardhmen. Ndaj nuk është fare e lehtë për mua të shkruaj për të shkuarën, për të ardhur deri tek momenti ku jam sot.

Çdo gjë ishte e bukur, ah sa e bukur ishte ajo kohë, duke filluar nga momenti kur pashë për herë të parë shkollën, për të vazhduar me momente tjera të veçanta, siç janë: krijimi i bazës themelore të personalitetit tim, ndërtimi i asaj mikrobote të vogël brenda atyre mureve, e ku çdo gjë është thesar në mendjen dhe zemrën time.

Tani mund të them se kam mbyllur kapitullin e fëmijërisë dhe e kam hapur kapitullin si një vajzë e

rritur.

As kjo nuk është fare e lehtë, pasi që çdo përgjegjësi më është dyfishuar. Por nga ana tjetër mund të them se jeta është më e bukur, pasi që arrin të kuptosh gjërat shumë më lehtë.

S'e mohoj faktin që gjendem në një rrugë me shumë dalje, por që s'mund ta di se përfundimi i cilës rrugë do të më shpie në dritë, e kësaj i thonë: udhëkryqi i jetës!

Misioni im në këtë rrugë është që të triumfoj e të mos dorëzohem, madje edhe të mos mendoj që është e vështirë t'ia dalësh.

Medina Ramadani 10/4



POETËT

Njëri shkroi për Atdheun,
njëri shkroi për Flamurin,
njëri shkroi për Shqipërinë,
njëri shkroi për Lirinë.

Njëri shkroi për bagëti,
shumë pak prej tyre shkruan për familje.

Shumë pak prej tyre shkruan me humor
dhe komedi. Pse?

Pse të kesh shtëpi?

Kur në atë shtëpi mungon dashuria,
mungon gëzimi,
mungon rehatia,
mungon e qeshura,
mungon frymëzimi,
mungon vullneti i jetës,
mungon arsyeja,
mungon qëllimi,
mungon kureshtja,
mungon vetvetja, Pse?

Pse të qash për gjëra që kalojnë,
pse të qash për gjëra që i harron,
pse të qash për gjëra që s'i kupton,
të qash për të kaluarën,
mos ta lësh atë pas, vetëm, vuajtje dhe
hidhërim.

Zbulo!


Zbulo çfarë të bën të lumtur,
zbulo çfarë gëzimit tënd i jep jetë,
zbulo çfarë e bën jetën tënde më të bukur,
Zbulo dashurinë e vërtetë.

Qesh!

Qesh o njeri!

Qesh, sepse jeta është më e vlefshme se çdo
pasuri,
qesh se do jetosh,
se ke arsye,
se ke vullnet,
se ke frymëzim,
se ke kureshtje,
se ke qëllim,
se je vetvetja,
se ke dashuri,
dashurinë e familjes,
dashurinë e Nënës dhe Babait,
dashurinë e Motrës dhe Vëllait,
shfrytëzo atë dashuri,
dashuri dhuro edhe ti!

Adni Sogojeva, 10/1



TURNIRI I FUTBOLLIT SHKOLLOR

Një kënaqësi dhe entuziazëm të veçantë patën nxënësit e shkollës, me rastin e organizimit të turnirit të futbollit të këtij viti shkollor, 2024 , i cili u zhvillua për dy ditë me radhë.

Pjesëmarrësit e garës ishin gjashtë ekipe të shkollës: 10/1, 10/2, 11/1, 11/2, 12/1 dhe 12/2.

Në pesë ndeshjet e zjarrra që u zhvilluan, finalistët nga klasa 11/1 dhe 11/2 u ballafaquan të nesërmen e këtij turniri

Fitues doli të jetë ekipi 11/2, i përbërë nga lojtarët: Hamza Abazi, Haris Krasniqi, Ebubekër Haziri, Almir Gashi e Shqipdon Veseli, bashkë me kapitenin e tyre Rejan Qerimin.

Këto ndeshje argëtuese u organizuan nga drejtoria e shkollës, stafi i shkollës me menaxhimin dhe referimin e profesorit të Ed.Fizike, prof. Valon Brajshori.

Në fund kupa iu dorëzua fituesve nga



drejtori dhe kujdestari i klasës, prof. Kujtim Jashanica.

Sa për të tjerët që nuk arritën fitoren, nuk ka problem, e dimë se “e kanë pasur nijetin e mirë”, prandaj të gjithë ishin fitues!



TURNIRI I FUTBOLLIT NDËRSHKOLLOR

Medreseja Alaudin mori pjesë në turnirin ndërmjet Shkollave të Mesme të Prishtinës. Vendi i zhvillimit të këtij aktiviteti ishte ish objekti i gjimnazit "Eqrem Qabej" në Prishtinë.

Ekipi i përzgjedhur për të përfaqësuar shkollën tonë në këto gara u përbë nga nxënësit: Ibrahim Hasangjekaj, 12/2,

Abdullah Sejdiu, 12/1, Melos Surkishi, 12/1, Omer Dalipi, 12/2, Amar Ahmeti, 11/2, Amar Tërnavë, 11/2 dhe Abdusamed Kamberi, 11/2.

Djemtë tanë shfaqën angazhim, taktikë e bashkëpunim në fushë, duke paraqitur Medresenë si shkollë të fortë edhe në sporte, për çka na bënë shumë krenarë.

Medreseja krenohet me nxënësit e saj!



MEDRESEJA, E AFTË EDHE NË MUNDJE!

Pa dyshim se Medreseja Alaudin, gjithëherë ka pasur nxënës entuziastë dhe të suksesshëm në shumë fusha. Mes tyre është edhe nxënësi Abdullah Ganiu nga klasa 10/1, i cili fitoi vendin e dytë në turneun ndërkombëtar "Adem Jashari" në mundje, i mbajtur në Suharekë. Abdullahu tregoi profesionalizëm gjatë zhvillimit të garës. Ne e urojmë Abdullahun dhe e inkurajojmë dhe e përkrahim atë në suksese të mëtejshme!

Jemi krenarë me nxënësit tanë!



AKTIVITETI NDËRKURRIKULAR (KURAN-DAVE-SOCIOLOGJI)

Aktiviteti ndërkurrikular përfshinë lëndët e fushës kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi, Kuran, Dave dhe Sociologji. Përndryshe, ky është aktiviteti i parë i kësaj natyre që në bashkëpunim me të tri lëndët rezultoi me një program të bukur në ambientet e Medresesë.

Temat që trajtoi aktiviteti në fjalë kishin të bënin me besimin, familjen, solidaritetin, respektin dhe sjelljet devijante, me një synim të vetëm: Sensibilizimin për ngritjen e vlerave shoqërore e njerëzore.

Ky synim fisnik përçoi mesazhe shumë domethënëse tek nxënëset e shkollës sonë nga perspektiva e mësimave kuranore, me prof. Valbona Asllani për lëndën e daves islame, me prof. Driton Arifin dhe me prof. Liriana Gërvalla për lëndën e sociologjisë.

Programi u hap me leximin e disa ajeteve nga Kurani fisnik nga nxënësja Rumejsa Merxha 12/4.

Moderatore ishin: Esma Sylejmani 12/3 dhe Amela Dushi 12/4.

Drejtori i Medresesë prof. Fadil ef.Hasani pati një fjalë rasti, ku shprehu falënderime drejtuar Krijuesit të Gjithësisë i cili bekoi familjen e shoqërinë njerëzore, veçanërisht Ummetin e Muhamedit a.s. E më pas falënderoi edhe organizatorët e këtij programi.

Në vijim u shfaqën disa sekuenca teatrale të përgatitura nga nxënëset Esma Metolli dhe Esra Bytyqi 12/4 me temën “Debati mes profesorit ateist



dhe nxënëseve besimtare”, të interpretuar nga Esra Bytyqi, Erda Musliu dhe Sumeja Tahiri.

Pastaj u paraqitën disa slajde me synim ndërgjegjësimi të përgatitura nga nxënësja Haxhere Idrizi, pasuar me një film të metrazhit të shkurtër me titull “Bir, më mbyt para se të migrosh” me regji, Shkëlzen Marefci.

U interpretua në fund edhe një pjesë teatrale nga nx. Belkisa Myrta, Elma Kameri, Rona Jahja e Lumnie Sadiku me tekst nga nxënëset: Esma Metolli, Lumnie Sadiku e Esma Sylejmani.

Në përmbyllje të programit u shpërndanë bookmaks për të gjithë të pranishmit.



KONFERENCA “GITOMUN” NË STAMBOLL

Më 18.11.2024 udhëtuan për në Stamboll 9 nxënëse nga Medreseja Alaudin e Prishtinës, Gjilanit dhe Prizrenit, për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare “Gitomun” të nxënësve, të cilën e organizon shkolla e vajzave Güngören KIZ Imam Hatip Lisesi në Stamboll.

Ato udhëtuan nën përkujdesjen e prof. Hatixhe Jashanica dhe prof. Diona Berisha.

Në kuadër të kësaj konference Medreseja Alaudin u rendit me dy vende të dyta dhe dy vende të treta, për çka dëshmon për seriozitetin dhe aftësitë e nxënësve të shkollës sonë.

VENDI I DYTË:

Sumeja Tahiri 12/3, Pr. dhe Sara Shamolli 11/4, nga Prishtina.

VENDI I TRETË:

Rujejda Bejtullahu 12/4, Pr. dhe Enesa Karaxhi 12/7, Pz.

Nxënëset pjesëmarrëse:

1. Sumeja Tahiri 12/3, Pr.
2. Sara Shamolli 11/4, Pr.
3. Ruvejda Bejtullahu 12/4, Pr.
4. Enesa Karaxhi 12/7, Pr.
5. Miranda Kryeziu 12/6, Pz.
6. Hana Maloku 12/9, Gj.
7. Amra Haxhiu 11/3, Pr.
8. Enisa Llumnica 10/4, Pr. dhe
9. Sara Hoti 10/5, Pr.

Nxënëset i urojmë, duke iu dëshiruar suksese të mëtejshme!



THE GREAT LAUNDRY INCIDENT

Barry had a gift for turning simple chores into disasters, and laundry was his ultimate nemesis. Determined to break the cycle, he headed to the laundromat with a mountain of clothes and newfound confidence.

The place was packed, and Barry snagged the last machine— until a feisty old woman claimed it. After a sharp exchange, Barry surrendered and settled for an ancient, rickety washer. He loaded it, overdid the detergent, and hit start.

Minutes later, the machine vibrated violently, then burst open, spewing bubbles and flinging his laundry across the room. Underwear soared through the air, landing on a weightlifter and a crying toddler. Chaos erupted.

As Barry hid in embarrassment, the elderly woman handed him a sock, cackling, “Karma’s a kick, isn’t it?”

Barry collected what he could, leaving behind his pride—and a pair of boxers stuck to a dumbbell. “Next time,” he muttered, “I’m just buying new clothes.”

The End.

Sudejs Mehmeti 12/2



LARG NGA VENDI IM

Kur ftohet koha, e fillon të fryjë
Dhe toka mbushet me dëborë
Zog i mërzhitur në strehë hynë
Rri i vetëm- krejt i gjorë


Sheh ngjyrat duke u shuar
Nga e bardha e borës që ka rënë
S’sheh zogj të tjerë duke fluturuar
S’guxon më as të bëjë një zë

Pret, e pret, ditë e natë
Sa zë koha për t’u qetësuar
Dhe nisë krahët t’i ngrohë
Bëhet gati për të fluturuar

Fluturoi shumë më larg
Në vend tjetër ai shtegtoi
Por zemra e mendja i rri
Tek vendi ku gjatë jetoi

Edhe pse në vend tjetër
Zogu gjeti shumë më mirë
Vendi i vet në mend i rri
Të kthehet sërish- ka shumë dëshirë.

Sara Kurtolli



BIRI IM

Ti je i dashur si djalë i vogël që ishe,
njeriun e veçantë që je tani
Dhe një djalë i mrekullueshëm që do të jesh


Gjithmonë!

Enes Hoti 12/1

SINQERITET

Këtë kullë që e ndërtova
Më dhimbset ta shkatërroj
Djalli vjen, në dhomat e saj pushon
Pas një dite të suksesshme
Unë si i hutuar i shërbej
Me sy magjepsur
Veç nëse mbledh forca thuajse të shuara
Një kullë të re t'ia nis
Gjersa çekani i fundit i zemrës
i syrit, i veshit, i qenies e i çekiçit të japë goditjen e fundit
E kur djalli të vijë kurdoherë
Ta gjejë portën e mbyllur me dry të trashë
E mbishkrimin i dëshpëruar ta lexojë: singëritet .

Ron Bajoku 12/2



يابن ادم..

يابن ادم خلقت السموات و الأرض ، و لم أعي بخلقهن ايوعين رغيث عيش أسوقه لك، يابن ادم لا تسألني رزق غد كما لم اطلب منك عمل غد.

الرزق

و من عجيب امر الرزق ان رزق كل إنسان يعرف عنوانه و انت لا تعرف عنوان رزقك الصلاة و سلام عليك يا سيدي يا رسول الله يا اذن الخير التي استمعت لآخر إرسال السماء ويا لسان صدق الذي بلغ عن الحق مراده من الخلق

Enes Hoti 12/1

لقد اصطفاك الله لهذه المهمة العظيمة!

نحن جميعًا شهود على أن كل شيء سينتهي يومًا ما، ونعلم أن علامة نهاية أي شيء هي بدايته. لقد بدأنا هذه الرحلة التي استمرت ثلاث سنوات، والتي وصلت الآن إلى نهايتها. منذ اللحظة التي خطونا فيها أول خطوة في هذه المدرسة، جعلنا الله مكرمين بين عائلاتنا، وأصدقائنا، وجماعتنا. رزقنا الله بالعلم النافع، وزيننا بأخلاق حسنة، ولقد عهد الله إلينا بدينه. ولماذا أكرمنا الله بكل هذه النعم؟ لأننا كل يوم نسمع كلمات: "قال الله"، "قال الرسول"، وهذه نعمة عظيمة.

والله، لقد اصطفاك الله لهذه المهمة العظيمة، وأوكل إليك أمانة دينه. لذلك، يا أخي العزيز، حتى إذا أصبحت غداً طبيباً، أو معلماً، أو تاجرًا، أو أي شيء آخر، فالتزم بدين الله واحفظ الأمانة التي أوكلها الله إليك.

Ensar Veseli 12/2

يَا رَبِّ، أَنْتَ نُورِي وَرَجَائِي

يَا رَبِّ، أَنْتَ رَجَائِي فِي الدَّجَى وَالسَّحَرِ

إِلَيْكَ تَزُنُّ عُيُونِي بَيْنَ دَمْعٍ وَوَتَرٍ

رَحْمَتُكَ بَحْرٌ عَظِيمٌ لَا يُحَدُّ شَرْفًا

فَاجْعَلْ لِي النُّورَ فِي دَرْبِي إِذَا ضَاقَ الْمَطَرُ.

Visar Rama 12/1



HAYAT SUDAN GELİR

Enbiya Suresi (21:30)'da Allah Subhanehu ve Teala şöyle buyuruyor: "Biz her canlı şeyi sudan yarattık. Hâlâ inanmayacaklar mı?" Bu basit ama güçlü ifade, modern bilimin hayat hakkında keşfettiklerini doğrular niteliktedir.

Bilinen tüm yaşam formları, en basit bakteriden en karmaşık organizmalara kadar hayatta kalmak için suya bağımlıdır. Vücudumuzun büyük bir kısmı sudan oluşur—yaklaşık %70'i! Su besinleri taşır, atıkları uzaklaştırır ve vücudumuzdaki tüm süreçlerin sağlıklı çalışmasını sağlar. Bitkilerde, hayvanlarda ve insanlarda her hücre hayatta kalmak için suya ihtiyaç duyar. Hatta en küçük canlı olarak kabul edilen bakterilerin bile yaşamlarını sürdürebilmek için suya ihtiyaç duyar. Bu, suyun ne kadar önemli olduğunu ve Kur'an-ı Kerim'in bunu çok önceden nasıl vurguladığını gösteriyor.

Besira Smajli 12/3

VAZGEÇME

Hedeflerinize ulaşmaktan asla vazgeçmeyin Hayatta güzel manzaralar elde edebilmek için öncelikle ne istediğimizi belirlemeliyiz. Kişiliğimizi ne derece geliştirdiğimiz, belirlediğimiz hedefler ve zaman yönetimi, hayyataki hedeflerimize ulaşmamız

için çok önemlidir. Yüksek bir motivasyon ve azim ile çalışmalıyız. Zorluklarla karşılaştığımızda ise nihai sonucu düşünmeliyiz. Hayyataki önemli hedeflerimiz için büyük adımlar atmamız. Her daim, hayalini kurduğumuz hayata ulaşmak için, durmadan o hedefe ulaşana kadar çalışmalıyız. Yüksek hedefler koymalıyız. Dünyaları değiştirecek hedeflerin anahtarı: umut ve sabırdır. Sade bir hayat için değil, yüksek hedeflere doğru yürümeliyiz. Hedeflerimiz bizim haritamız olmalı. Bu da bizim kararlılığımızı sağlayacaktır. Hedefleri adeta bir harita gibi zihninizde canlandırmalıyız Hedeflerinize tutunmak bize özgüven ve istikrar kazandırır. Bizi başarının zirvesine ulaştıran şeyler şunlardır: amaç, zaman, olumlu motivasyon, sürekli kararlılık. Umut etmeliyiz, kendimize inanmalıyız, defalarca düşsek de kalkacağız ve o karanlık tünelin sonunda devam etmemiz için ilham veren o umut ışığı bizi bekleyecektir.

Rumejsa Merxha 12/4



PJESËMARRJA NË KUVENDIN E ORGANIZUAR NGA KYC

Më datën: 25.10.2024 u mbajt kuvendi zgjedhor i Këshillit të Nxënësve të Prishtinës ku morën pjesë: Ruvejda Bejtullahu, Enes Islami, Naser Mehmeti, Amra Haxhiu dhe Suela Ademi.

KNPr është një grup formal, përfaqësues i nxënësve të të gjitha shkollave të mesme të larta në komunën e Prishtinës.

Këshilli i ri zgjidhet çdo vit, ndërsa bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe shkollat e mesme, duke përfaqësuar zërin e nxënësve të kësaj komune në KNK.

Ne votuam për më meritoret.



KONFERENCA “NXËNËSIT, PAQJA DHE SIGURIA”

Më datën: 18.11.2024 u mbajt konferenca “Nxënësit, Paqja dhe Siguria” ku përfaqësuesit e nxënësve dhe palët kryesore me interes, u mbledhën së bashku për të diskutuar mbi Agjendën, “Rinia, Paqja dhe Siguria” (YPS).

Kjo ngjarje përfshiu:

- a) punë në grupe për krijimin e Planit të Veprimit për Paqen dhe Sigurinë në shkollat e mesme të larta,
- b) njohuri nga folës të fushës dhe një panel diskutimi mbi adresimin e çështjeve të sigurisë në arsim,
- c) rrjetizimin me përfaqësuesit e nxënësve nga shkollat e ndryshme në Kosovë.

Nga shkolla jonë prezantuan: Enes Islami dhe Naser Mehmeti.



“16 DITË TË AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS NË BAZA GJINORE”

Më 03.12.2024 në Tech Park në kuadër të fushatës globale “16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore”, Ministria e Drejtësisë, Znj. Albulena Haxhiu organizoi një aktivitet, ku nxënësit tanë: Enes Islami 12/2, Riad Avdiu 12/1, Visar Rama 12/1, Naser Mehmeti 11/2, Enes Hoti 12/1, Ruvejda Bejtullahu 12/4, Esma Metolli 12/4, Belkisa Myrta 12/3, Besira Smajli 12/3, Edina Smajli 11/3 morrën pjesë në aktivitetin me temë “Ndikimi i Rrjeteve Sociale tek të Rinjtë”.



PINGPONG

Në turnirin e pingpongut ndërshkollor mes shkollave të mesme të Prishtinës e që mbahet çdo vit, morri pjesë edhe kësaj radhe “Medreseja e Mesme Alauddin” – shkolla amë, në kuadër të turnirit për meshkuj dhe të atij për femra.

Sa i përket ekipit të meshkujve, ai u përfaqësua nga nxënësit: Omer Demolli, 12/2, Amar Gjikoili, 12/2 dhe Muhamed Hasangjekaj, 10/1.

Ndërsa nga ekipi i femrave, përfaqësuese ishin nxënëset:

Shkurta Ajeti, 12/3, Sara Rrustemi, 12/3 dhe Sara Blakaj, 11/3.

Shkolla inkurajon nxënësit e saj për pjesëmarrje në evente të tilla sportive gjithëherë!



GARAT E VOLEJBOLLIT

Më datë 19.12.2024 u mbajtën garat e volejbollit ndërmjet paraleleve të vajzave të shkollës sonë në sallën e brendshme sportive, ku pati një angazhim dhe lojë të fortë nga të gjitha ekipet pjesëmarrëse.

Megjithatë fituese e kësaj gare doli klasa 10/3, me lojtaret:

1. Aksa Jusufi
2. Lea Bekteshi
3. Seuda Gjikko
4. Lina Canolli
5. Arjeta Rudari
6. Sara Zhushi

Urojmë nxënëset fituese por edhe të gjitha nxënëset pjesëmarrëse për organizime të tilla!



“MREKULLIA E KRIJIMIT: NJË HARMONI MES SHKENCËS DHE HYJNORES”

A është ndalur ndonjëherë zemra juaj nga mahnitja, vetëm duke menduar se si keni arritur në jetë? Si mundet që një pikë e padukshme të shndërrohet në një qenie të ndërlikuar, me zemër që rrah, mendje që arsyeton dhe ndjenja që i japin kuptim jetës? Procesi i krijimit të njeriut është një udhëtim i jashtëzakonshëm, që sfidon çdo imagjinatë. Ajo që shkenca sot e shpjegon me fakte, mbetet një mister i mrekullueshëm për shumikënd. Si mund të ndodhë një proces kaq i saktë, kaq i planifikuar dhe kaq i përsosur?

Sipas shkencëtarëve, krijimi fillon me fazën e nutfa-s, kur një qelizë vezë e fekunduar formohet nga bashkimi i spermës dhe vezës. Dr. Keith Moore, një nga ekspertët kryesorë të embriologjisë thotë:

“Zigota, e cila krijohet pas fekondimit, është pika fillestare e jetës dhe përmban të gjithë informacionin gjenetik të individit”.

Më pas, ajo ndahet dhe lëviz drejt mitrës për t’u ngjitur në murin e saj, një fazë që shkencëtarët e përshkruajnë si një masë të ngjitur që kërkon ushqim për të vazhduar zhvillimin.

Pas implantimit, fillon faza e mudga-s, ku embrioni merr formën e një mase të përtypur, e ndarë në segmente që do të zhvillohen në organe dhe inde.

Dr. E. Marshall Johnson shpjegon:

“Në këtë fazë fillojnë të shfaqen konturet e sistemit skeletor dhe indet muskulore, duke krijuar bazën për zhvillimin e mëtejshëm.”

Por ajo që është më e mahnitshme është përputhja e këtyre përshkrimeve me një shpallje hyjnore të zbritur më shumë se 1400 vjet më parë. Në Kur’an thuhet:

“Ne e krijuam njeriun nga një pikë fare (nutfa), pastaj e bëmë atë një droçkë të ngjitur (aleka), e pastaj e shndërruam në një copë mishi të përtypur (mudga), pastaj nga ajo krijuam eshtrat dhe eshtrat i veshëm me mish, e pastaj e bëmë krijesë tjetër.

I Madhëruar qoftë Allahu, Krijuesi më i përsosur!” (Sureja El-Mu’minun: 12-14).

A nuk ka arritur koha pra të reflektojmë?!

Esma Metolli 12/4



30 VJETORI I MEDRESESË ALAUDDIN - PARALELJA GJILAN

Një manifestim i mrekullueshëm u mbajt në ambientet e Medresesë Alauddin- paralelja Gjilan, me rastin e 30 vjetorit të themelimit të saj.

Ku u këndua Kuran, pati fjalime nga të pranishmit si : Myftiu i BIK-ut, Naim ef. Tërnavë, drejtori i Medresesë, prof: Fadil ef. Hasani, ministrja e Shkencës, Arsimit dhe Teknologjisë, znj. Arbërie Nagavci, kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni e të ftuar të tjerë, u mbajt një pikë teatrale që kryefjalë e pati mulla Idriz ef. Gjilanin, pati ilahi etj.

Programi u moderua nga prof. Shefqet Krasniqi.

Mes kësaj hareje u përkujtua disa herë vlera e kësaj shkolle dhe frytet që ajo ka nxjerrë ndër vite.

Një përvjetor për t'u mbajtur mend!



GRUPI I NXËNËSVE TË DALLUAR TË MEDRESESË VIZITOJNË STAMBOLLIN

Pas një angazhimi dhe suksesi të treguar përgjatë një viti shkollor, drejtorja e Medresesë vendosi që t'i shpërblejë nxënësit e dalluar të saj me një vizitë në Stamboll.

Nxënësit në fjalë, gjithësj 14 vetë bashkë me kujdestarët e tyre, prof. Adnan Simnica, Muhamed Stublla e Selim Selimi, mbërritën më 01.01.2025 në aeroportin Sabiha Gökçen, prej nga u pritën e u dërguan në ambientet e shkollës së binjakëzuar atje "Kartal Imam Hatip Lisesi" e cila siguroi akomodimin e grupit të Medresesë, shëtitjen e tyre në pikat më turistike të Stambollit dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera. Nxënësit në ditët e para patën mundësinë të njihen me kompleksin gjigand të shkollës Kartal Imam Hatip Lisesi, ndër të tjera edhe kabinetin e kimisë, ku morrën pjesë në realizimin e një eksperimenti, sallën e diskutimit për gj. angleze ku morrën pjesë në një orë mësimi, e poashtu edhe në një orë mësimore të gj. Arabe. E në vijim, sa i përket qytetit, nxënësit vizituan xhaminë Eüyp sultan dhe tregun përreth, rrafshnaltën e quajtur Pierre Loti nga

e cila mund të shihej një pamje e bukur e Stambollit, Topkapı sarayı me muzetë përreth, Beylerbey saray, Xhaminë Sulltan Ahmet, xhaminë Aya Sofia, komunën Fatih Belediyesi, Mısır Çarşısı, Yeni Cami, xhaminë Mihrimah sultan.

Mes të tjerash pati edhe një shëtitje me anije nëpër ujërat e Bosforit e u vizitua edhe xhamia gjigande Çamlıca Cami.

Vizita kaloi kufijtë e Stambollit e u ndal edhe në Bursa, ku u vizituan mes tjerash, lagja e vjetër Cumalıkızık. Pastaj qendra e qytetit të Bursas, xhamia Ulu cami, tregu kryesor pranë xhamisë, zyra për kulturë e Kosovës në Bursa, kalaja e Bursës në të cilën gjendeshin varret e sulltan Osmanit e të birit të tij Orhanit bashkë me familjet e tyre mbretërore.

Në fund u bë kthimi i sërishëm në Stamboll prej nga nxënësit përmbyllën vizitën e tyre një javorshe, duke u kthyer me aeroplan në vendlindje më 07.01.2025.

Falenderojmë drejtorinë e shkollës sonë si dhe atë të shkollës nikoqire për mundësinë e dhënë!



NXËNËSET E DALLUARA VIZITOJNË ANTALINË

Më datën 02.01.2025 grupi i nxënësve të Medresesë me gjithësej 14 veta, nën përkujdesjen e prof. Hatixhe Jashanica, Cansu Drangoy dhe Sevdie Arifi Osmani udhëtuan për në Antali të Turqisë.

Pritja e akomodimi i tyre u bë nga shkolla e binjakëzuar me Medresenë Alauddin, “Mahmut Celalettin Ökten Kız Anadolu İmam Hatip Lisesi”.

Nxënëset filluan me vizitën në muzeun e Antalisë (Antalya Müzesi) e që njihet për vjetërsinë dhe vlerën e madhe që ka. Pastaj vizituan lagje të Antalisë, rrugët dhe ndërtesat e së cilës i karakterizonte arkitektura selxhuke dhe ajo osmane. Vizitë iu bë edhe kalasë (Kaleiçi), ujëvarës Düden me pamje e saj të mahnitshme. Pastaj nxënëset vazhduan drejt Çarshisë Qëndrore të Antalisë, ku patën mundësinë të bënë Pazar. Medrsistet bashkë me profesoret falenderuan drejtorin e shkollës së binjakëzuar, z. Yılmaz Güney, drejtoreshën e një shkolle tjetër, znj. Hatice Koçoğlu me shoqëruesen Seher Kaya të cilët u përkujdesën që çdo gjë të jetë në rregull dhe të mos mungojë asgjë.

Një falenderim i shkon padyshim edhe drejtorisë së shkollës sonë për mundësinë.

Kthimi i grupit u bë më 09.01.2025.



DELEGACIONI I MEDRESESË VIZOITON ANKARANË



Më 01.01.2025 delegacioni i përbërë nga drejtori i Medresesë së Mesme Alauddin, prof. Fadil ef. Hasani dhe profesorët: Almedin Ejupi (koordinator i paraleles në Prizren), Driton Arifi, Shemsi Rrahimi, Selatin Mehani e Ramadan Uka udhëtuan për në kryeqytetin turk Ankara për çështje pune, ku u pritën e u akomoduan në shkollën e binjakëzuar me Medresenë tonë, "Shehit Osman Halisdemir" Imam Hatip Lisesi nga drejtori i shkollës, z. Jashar Keskin me stafin e tij.

E si shenjë respekti e afërsie, z. Keskin, me bashkëpunëtorët, nxënësit e shkollës e mësimmëdhënësit organizuan një program kulturor enkas për delegacionin mysafir.

Në vijim drejtori me profesorët vizituan zv. Kryetarin për Edukim dhe Arsimit të Ministrisë së Arsimit, z. Mehmet Nezir Gül pastaj edhe me Dr. Ahmet Ishleyen, Drejtor Gjeneral për Çështje dhe Arsimit

Fetar në Ministrinë e Arsimit, më pas Dr. Musa Kazim Arican, rektorin e Universitetit Sosyal Bilimler (Shkenca shoqërore) e njehërit edhe kryetar i Shkrimtarëve.

Falja e namazit të Drekës u bë më pas në xhaminë "Haxhi Bajram Veli" duke vazhduar me vizitën tek muzeu "15 Temmuz", Pallatin Presidencial etj.


Mes vizitave të rëndësishme ishte edhe ajo që grupi nga Medreseja ia bëri myftiut të Gaziantepit, Dr. Hyseyin Hazirlar në Qendrën e Diyanetit për të Rinj, ku u diskutua për veprimtaritë e dy trupave fetare udhëheqës, Diyanetit e BIK-ut.

Nga vizitat interesante ishte edhe ajo e Urfës, parkut antik ku lindi Ibrahim a.s, aty ku u hudh në zjarr etj.

Vizita u përfundua më datë 07.01.2025.

Dashtë Allahu ishte një vizitë e frytshme për shkollën tonë. Urojmë drejtorin dhe profesorët tanë.

FJALËTËRTHORE



Horizontalisht:

2. Shtet në Jug-Lindje të Afrikës
4. Imam në Mekë
7. Qytet në Palestinë
9. Shkenca e cila merret me komentimin e Kuranit
11. Medhheb në Akide
14. Firmë
15. Djath italian
17. Profeti më i përmendur në Kuran

Vertikalisht:

1. Kryeqytet i Sirisë
3. $a^2 + b^2 = c^2$
4. Hallalli më i urryer
5. Emri i parë i Medinesë
6. Dijetar i hadithit
8. Pjesë e kompjuterit
10. كتاب (shqip)
12. Kushti i Pestë i Islamit
13. Landscape (shqip)
16. Koliqi, Shkrimtar shqiptar